



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

### Procesverbal 05/2024

I Mbajtur në takimin e V-të të rregullt të KK-së me datën 30.05.2024, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

#### **Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;**

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e V-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

#### **Rendi i ditës:**

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për vënie në Diskutim publik të Draft - Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Draft-Plani i Veprimit për Rinin 2024-2027;
5. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QKMF-së në Koshare;
6. Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrave kadastrale 1243-0, 1244-0 dhe 1245-3 Z.K. Sojevë, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 295-1 Z.K. Fshat i Vjetër, pronë e Komunës së Ferizajt;
7. Propozim – Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 467-2 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 469-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim – Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr.01.Nr.111 të datës 31.08.2022;

9. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 3206-0 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;
10. Propozim – Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 710-0 Z.K. Bibaj, me sipërfaqe prej 6 m<sup>2</sup>, KEDS-SH.A.
11. Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes;
12. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 692-4, 694-2, 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
13. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc, pronë e Komunës së Ferizajt;
14. Propozim – Vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Rrugicave dhe Shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale dhe
15. Të ndryshme.

**Kryesuesi i KK-së** mbasi përshëndeti të pranishmit ju uroi mirëseardhje në mbledhjen e 5-të të rregullt dhe pastaj e propozoi këtë rend dite të lartcekur, ndërsa në KPF theksoi se jemi pajtuar që të kemi caktimin e lokacionit në Zaskok për nevoja të komitetit të këtij fshati dhe 16 propozim për ndryshimin e vendimit 2863 të datës 30.12.2005 dhe 17 e kemi plotësuar ndryshimin e vendimit të fundit për bartje të hyrave vetanake dhe e kemi një korrigjim të vogël, a ka dikush rreth rendit të ditës dhe mbasi spati kryesuesi e hodhi në votim dhe kaloi me 34 vota për.

**Kryesuesi**, pyeti nëse ka dikush rreth procesverbalit dhe mbasi spati kaloi me 34 vota për.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 4 dhe ia kaloi fjalën Drejtorës Xhemile Murati Shabani e cila mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi se para vetes keni një dokument të Draft strategjisë së rinisë për Vitin 2024-29 është një dokument mjaft i rëndësishëm për komunën dhe për komunitetin, në përgjithësi vlen të theksohet se mbështetet edhe nga ambasada dhe departamenti i shtetit Amerikan, dhe normalisht implementohet nga ministria dhe vetë Komuna e Ferizajt.

Dhe normalisht të gjitha rekomandimet që do vinë gjatë dëgjimit publik do të shiqojmë s'bashku,

**Arbnora Salihu**, mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi se fillimisht dua të përgëzojë ekipin punuese për këtë plan duke përfshirë edhe Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, OJQ, dhe grupet e interesit për punën e këtij drafti, sepse për herë të parë kemi një strategji për rinin dhe kjo është shumë shpresë dhënëse për rinin ferizajase, i kam lexuar me kujdes 7 qëllimet që i përmban

strategjia dhe formën se si është trajtuar për rinin dhe më lejoni që të shtoj disa nga rekomandimet, megjithëse edhe gjatë dëgjimeve publike do të kemi mundësinë që të paraqesim qëndrimet tona, në pikën 5.3 janë përdorur terme jo adekuate dhe ka nevojë që të shtjellohen edhe më tepër, në pikën 5.4 ndër faktorët kyç është paraqitur edhe mungesa e kohës së lirë dhe unë mendoj që ky faktor nuk ekziston, por mund të përkufizohet si menaxhim jo i mirë i kohës së lirë, por pajtohet me faktorin kyç, me faktorin e mundësive financiare dhe infrastrukturës i cili i limiton mundësitë e rinjve kudo që janë aktiv fizikisht, ndërsa tek aktivitetet e para në faqen 15 dhe 16 ku është përgatitja e të rinjve për tregun e punës, mendoj se është shumë e rëndësishme të parashihet një analizë e detajzuar e tregut të punës, gjithashtu të bëhet një hulumtim sa prej tyre nuk vazhdojnë studimet etj., dhe për fund për shkak të ndjeshmërisë kërkoj që të bëhet përmirësimi i termave të personave me nevojë të veçanta dhe atyre me aftësi të kufizuara, ju faleminderit.

**Kryesuesi,** pyeti nëse ka dikush tjetër diçka për të shtuar dhe mbasi spati kaloi me 34 vota për.

**Kryesuesi,** lexoi pikën e 5-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se ky propozim ka të bëjë me caktimin e lokacionit në fshatin Koshare, në KPF u pyet nëse ka dikun ndonjë vendim për lapidar, unë shikova mirëpo nuk ka ndonjë vendim të tillë, Kryesuesi pyeti nëse ka dikush për të diskutua dhe fjalën e mori Amir Rexhpi i cili mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi se një kërkesë e kahmotshme e banorëve të fshatit Koshare po jetësohet dhe unë kërkoj nga të gjithë që ta përkrahin, Hatixhe Bungu mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi se edhe unë dola ta përgëzoj Komunën e Ferizajt që e dha lejen e kahmotshme të kuvendarve dhe të kryetarit të fshatit bashkë me banorë të këtij fshati, dhe lokacioni është i qëlluar mbasi aty gravirojnë barnatore, stacioni i autobusëve etj., shpresoj që edhe kuvendarët të japin dritën jeshile për këtë pikë të rendit të ditës.

**Sylejman Metushi,** theksoi se konsideron si diçka shumë të qëlluar, lokacioni është në vend të mirë që lidhen Fshati Koshare, Shlivavë, Lagjen Lubovc, andaj edhe njëherë urime për këtë projekt të qëlluar.

**Xhevdet Haxhidema,** mbasi përshëndeti të pranishmit absolut të gjithë jemi dakord sa i përket kësaj mirëpo duhet patur parasysh që nuk mund të quhet QKMF po QMF sa për korrigjim.

**Kryesuesi,** para se ta votojmë pavarësisht që kurrkush s'është kundër, duke pasur parasysh që në të njejtën sipërfaqe, në më shumë se 34 ari është fillu një bust, unë propozoj që në këtë sipërfaqe të paraqitet për 5 ari për bust ndërsa pjesa e mbetur për QMF dhe mbasi e hodhi në votim kjo pikë kaloi kështu me 34 vota për.

**Kryesuesi,** lexoi pikën e 6 dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se kjo pikë ka të bëjë me këmbim të ngastrave të lartcekura dhe këtu është bërë vlerësimi, është përfundu gjithçka dhe ju ftoj që ta përkrahni dhe kjo pikë mbasi u hodh në votim kaloi me 20 vota për, 3 abstenime dhe 0 kundër.

**Kryesuesi,** lexoi pikën e 7-të dhe ia kaloi fjalën drejtorit i cili theksoi edhe ky ka të bëjë me këmbim dhe këtu është përfundu vlerësimi dhe mbasi u hodh në votim kaloi me 24 vota për, 3 abstenim dhe 0 kundër.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 8-të dhe ia kaloi fjalën drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se ka të bëjë me plotësim ndryshimin vendimi 111 të datës 31.08.2022 dhe ndryshimi do të bëhet ashtu si është në propozim dhe kaloi me 24 vota për, 4 vota abstenim dhe 0 kundër.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 9-të dhe ia kaloi fjalën Sabri Murselit i cili theksoi se edhe ky propozim ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshëm arsyeja është krijimi i shiritit te Stacioni i autobusëve mirëpo këtu edhe nëse ka vlerë më shumë prona private nuk kërkon kompenzim shtesë dhe kjo pikë kaloi me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën 10-të dhe ia kaloi fjalën Sabri Murselit i cili theksoi se këtu bëhet fjalë për KEDS për vendosjen e trafos dhe pas miratimit të këtij vendimi do të nënshkruhet kontrata e veçantë dhe mbasi s'pat diskutime, kaloi edhe kjo pikë me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 11-të dhe Sabri Murseli theksoi se këtu duhet patur parasysh që kemi të bëjmë për miratimin e Raportit për të drejtën e parablerjes së këtyre banesave, pra në bazë të këtij raporti të gjithë kanë kontrata dhe mbasi spati të interesuar për të diskutuar, kaloi me 29 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 12-të dhe Sabri Murseli theksoi se edhe ky ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit, ashtu si është paraqitur edhe në propozim dhe po e shpjegoj edhe me monitor, nëse ka dikush diçka për të pyetur urdhëroni mirëpo mbasi nuk pat kaloi me 23 vota për 4 abstenime dhe 0 kundër.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 13-të dhe ia kaloi fjalën Sabri Murselit i cili theksoi se ky propozim ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshëm, duhet patur parasysh që është vendim fillestar dhe s'është vendim përfundimtar dhe kjo është kërkesë e palës, Brahim Osmani mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ky propozim që dua të bëjë 3 pyetje, kjo çështje është tepër me nguti, kërkesa e Bahri Xhemajlit për të sjellur me nguti brenda 3 jave, duke patur parasysh afërsinë e tij me pushtetin, besoj që çka do tjetër mund të jetë veç interes i përgjithshëm s'është, pra pyetja që dua të bëjë është pse është i rëndësishëm kjo kërkesë, si e arsyetoni i varfër është në interes të përgjithshëm dhe nën 3 çfarë rrugë janë ndjekur për të garantuar, se ky vendim është marr në rrugë të ndershme, prandaj ne kemi të drejtë të ngritim zërin, ky person përpos që merr tendera tash edhe paraqitet me nguti në disa seanca për t'ia këmbi pronën me pronat të komuës.

**Arian Imeri**, mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi se dola me fol për arsye se për këtë rast ka pas tendenca për me manipulu edhe ma herët sikur dikush po donë me dhanë diçka e dikush pe mbron, rruga është e shtrume aty, na sot jemi tu marrë me pasojat e një vendimi që është marr gjatë qeverisjes së Kryetarit Sfarqa, cili ka qenë arsyetimi që u ba aty, unë se di se s'kam qenë as pjesë e kuvendit, kushdo prej juve që ka diçka që gjatë këtij procesi urdhëroni thujeni ose këtu ose aty ku është vendi, na sot e kemi një situatë ku komuna rreth 23 ari ia ka marrë këtij dhe çështja a është a dojmë me ja pagu apo po dojmë me ja këmbi sipas vlerësimit që e bënë ministria, nuk ka mundësi si po doni ju me paraqit që na me ja marr e mos mi dhanë kurrë, cila nga këto mund të jetë më e përshtatshme, është në rregullë, duhet pasur parasysh që nëse shkojmë me pagesë duhet pasur parasysh që 6 vite do të ketë kamatë vonese e kështu me radhë, po përmendet këtu që ky merr tender, mirëpo këto dy çështje janë absolutisht të kundërta dhe s'kanë të bëjnë aspak në mes veti, qysh të doni ose me pagesë ose me këmbi po edhe nëse paraqitet me këmbi ne prap do të

vijmë këtu pas vlerësimit dhe nëse nuk na pëlqen vlerësimi mund ta refuzojmë, a është favorizu kur u shtru është çështje tjetër.

**Brahim Osmani**, e para veç sa tha drejtori, që implementimi është bërë gabim, nuk ka nevojë me e viju se fjalimi ke i jemi tjetra cila është lidhja që edhe ligji nuk ja lejon mu lidh prej Muhovcit në Talinove të Muhaxherve, është ofendim për kuvend sa herë po na e sjellni, herë një pronë herë një tjetër.

**Ibrahim Hyseni**, mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi, unë nuk di që ndonjë projekt është realizu dhe nuk është pagu prona është veç një formë kur ai deklarohet që e lëshon parcelen dhe nuk kërkon kompensim në këtë rast nuk ka diçka të tillë këtu, jemi në një pozicion ku ose duhet me pagu ose me këmbi, drejtori këtu tha që mund t'i propozojmë disa variante, mirëpo drejtor t'i mundesh mi paraqit, po nëse pala nuk e pranon d.m.th ajo punë nuk bëhet, na veç mund ta zgjasim procesin, mirëpo në këtë rast edhe unë jam i mendimit që ose ta paguajmë me mjete ose me variantin të cilin e ka pranua pala dhe e bënë vlerësimin ministria dhe më pas do të vije apet këtu dhe të shikojmë sa do që ta zgjasim krejt shkon në barrë të komunës.

**Kryesuesi**, këtë pikë e hodhi në votim dhe kaloi me 22 vota për, 6 vota kundër dhe 3 vota abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 14-të dhe ia kaloi fjalën drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi që është nevojë për futjen në sistem ARIS të këtyre të dhënave që kanë mbetur dhe nevojitet urgjentisht edhe 1 vit, anëtar të komisionit janë si në propozim pagesa do të jetë 500 euro në muaj.

**Flamur Istrefi**, mbasi përshëndeti të pranishmit fillimisht mendoj që sot është dashur të jetë edhe drejtori këtu, në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar nga zyra ligjore që të jetë një sqarim dhe sot nuk e kemi, pra as atë sqarim dy çështje këtu janë gabim pra është kompozimi për kryesuesin, pra Faikun ku nuk është cekur se sa mbledhje do të mbahen në muaj që i jep mundësi të keqpërdorimit dhe e dyta është ky personi që punon edhe në "Bifurkacion" madje edhe nga 5 janë bërë në 7 anëtarë pra veç çka janë rritur, mendoj që kjo çështje duhet të rishikohet nga zyra ligjore, të vije më pas me të gjitha elementet ashtu si duhet.

**Arian Imeri**, do të thotë ne të gjithë jemi pajtuar rreth rëndësisë së këtij komisioni dhe duhet të jetë funksional d.m.th. edhe në bisedë me Faikun, unë propozoj që ai të paguhet 30% ashtu si të gjithë anëtarët tjerë, ndërsa sa i përket ekspertit të Giz-it Premtim, unë propozoj të largohet mbasi është edhe vërejtje e opozitës edhe mban një punë tjetër, mendoj se futja e të dhënave në sistem veçse ka përfundua dhe kjo vajza Blerona mund që të bëjë futjen e të dhënave në program.

**Brahim Osmani**, unë desha të paraqes këtë çështje që kur ta votojmë ta rregullojmë njëherë e mirë mbasi te Ligji i pagave duhet pasur parasysh që nuk ka pagesë 50 euro, po është 180 dhe duhet të rregullohet mirë kjo çështje.

**Kryesuesi**, e paraqiti propozimin e Arian Imerit dhe ku për Faikun paga do të jetë 30% e pagës së asamblistit dhe hjeket nga anëtari i komisionit Premtim Asllani, ndërsa për anëtar të tjerë të komisionit do të jetë 500 euro në muaj. Kryesuesi e hodhi në kuvend dhe kjo pikë kaloi me 24 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 15-të për caktimin e lokacionit në Fshatin Zaskok në zonën 955 në Z.K. Zaskok prej 5 ari që do të shërbejë për të pame, a ka dikush diçka për të diskutua dhe mbasi spati kaloi me 30 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 16-të për ndryshimin e Vendimit 2863 të Vitit 30.11.2005 dhe kërkesa e familjareve të zgjatet nga 5 ari në 15 ari dhe duhet patur parasysh që nuk mund të shërbej për asgjë tjetër vetëm për lapidar. Arbnor Murseli mundësia që ne të ndaj 12 ari për Driton Islamin është nder për ne, ne si subjekt politik deklarojmë se do ta votojmë pro këtë propozim.

**Ismajl Sejdiu**, mbasi përshëndeti të gjithë theksoi se do të flas shkurt, megjithëse për gjakun e martirëve do të jemi gjithmonë për dhe mbështetës për këtë propozim për Driton Islamin, andaj bëjë thirrje që të përkrahni edhe ju pa dallime politike këtë propozim, mbasi nuk ka tjerë të interesuar për diskutim, mirëpo ne duhet ta precizojmë nga 10 -12 mirëpo mbasi drejtori po thotë 10 ari kush është për dhe kaloi me 30 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Kryesuesi**, lexoi pikën e 17-të, është plotësim ndryshim i vendimit të THV i mbledhjes së kaluar dhe do të bëhet një përmirësim teknik si e keni në propozim, kush është për dhe kaloi me 25 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pyetje dhe kërkesa**: Hatixhe Bungu për Drejtorinë e arsimit a do të kompensohen dhe si do të kompensohen punëtorët e kopshtit për muajin mars, të cilët kanë punuar dhe ende nuk janë kompensuar, kërkoj që ashtu si e kërkon rregullorja e kuvendit të më paraqitet përgjigjja për këtë pyetje.

**Ismajl Sejdiu**, kërkojë mbështje që në rishikimin e buxhetit të fusim ndërtimin e lapidarit në Fshatin Jezerc, e cila edhe është kërkesë e kahmotshme e banorëve të fshatit mbasi seriozisht gjendja e tanishme dëshmon një mungesë respekti për familjar dhe për të gjithë ata që do e shohin atë gjendje.

**Brahim Osmani**, kam disa kërkesa nga banorët e Fshatit Rahovicë po bëhen disa vite që janë buxhetu shtruarja e rrugicave dhe kërkojmë që ta dimë saktë kur do të bëhet, po ashtu në fshatin Mirosal lagjja e .... ka mbetë pa u rregullu rruga, sa i përket punëve tjera do të kisha kërku me shkrim apo këtu ta paraqesin këtu pyetje për këto çështje.

**Sadat Ismajli**, mbasi përshëndeti kam një kërkesë për Drejtorin e shërbimeve publike, kërkojë që mu nxjerr një rregullore për taksë, p.sh. Prishtina e ka dhe kërkesa e dytë në bazë të bisedave që kam pas me qytetar, pra rruga "12 Qershori" të jetë rrugë një kahëshe dhe të bëhet një parking në formë më ndryshme për një periudhë deri 20 minuta për të bërë pagesën e faturave apo diçka të tillë.

Në të ndryshme kryesuesi theksoi se në këtë pikë sa i përket vendimit për rregullimin e barnatorëve na është kërkuar nga ministria që ta rishikojmë, mirëpo unë fillimisht kërkoj që të anulohet ky vendim dhe më pas të shikohet, se si të bëhet më mirë dhe kaloi me 24 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Brahim Osamni**, propozoi që të zëvendësohet si anëtar i komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave lokale me Arbnor Murselin dhe ky propozim u votua me 24 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

**Kryesuesi**, pyeti nëse ka dikush diçka në këtë pikë dhe mbasi spati deklaroi se e shpall të mbyllur këtë mbledhje.

**Procesmbajtësi**



**Leutrim Mahmuti**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**